



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 15.2.2016, miratoi këtë

V E N D I M

I.

Me këtë vendim i rekomandohet Kryetarit të Komunës, që t'i propozojë Kuvendit të Komunës caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante.

II.

Në pajtim me pikën 1 të këtij vendimi, kërkohet nga Kryetari i Komunës që, në bashkëpunim me drejtorinë kompetente, brenda një afati të arsyeshëm kohor, t'i dërgojë Kuvendit propozimin konkret për caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante, si dhe të gjitha materialet e nevojshme përcjellëse.

III.

Ky vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.353 -52538, më 04.03.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.